

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK

Departamenti: E Drejta Financiare

Tema: Politika Fiskale dhe Rritja Gjithëpërfshirëse

Mentore: Prof.Ass.Dr. Fitore MORINA

Kandidate: Krenare KODRA

ABSTRAKT

Për funksionim të mirëfilltë të një shteti, është thelbësore aplikimi i një politike të shëndoshë fiskale që ka tendencën të ndikoj në rritje gjithëpërfshirëse.

Politika fiskale i referohet kryesisht përdorimit të tatimeve dhe shpenzimeve qeveritare, e një kombinim i këtyre të dyjave, në mënyrë që të jetë optimal si për qeverinë ashtu edhe për shoqërinë, do të duhej të kishte efektet e saj pozitive duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e të gjitha segmenteve që e përbëjnë shtetin.

Hartimi i politikës fiskale bazohet në ndërtimin e një sistemi adekuat tatimor dhe në shpërndarje efektive të të hyrave. Dizajnimi i sistemit tatimor bëhet duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm, si zhvillimi historik, rregullimi politik, madhësia e vendit, numri i popullësisë dhe niveli i zhvillimit ekonomik, me qëllim që t’i ndihmoi shtetit në gjenerimin e të ardhurave dhe shpenzimin e atyre të ardhurave për rritje gjithëpërfshirëse. Tutje, politika e shpenzimeve publike formësohet duke konsideruar gjithashtu nivelin e zhvillimit të vendit, pastaj edhe të hyrat publike në dispozicion dhe natyrisht, nevojat themelore të shoqërisë.

Strategjia kryesore e një shteti për të arritur objektivat e saj për rritje ekonomike, mirëqenie sociale apo thënë përgjithësisht, rritje gjithëpërfshirëse, në mënyrë të pa-kontestueshme konsiderohet të jetë politika fiskale.

Fjalët kyçe: *Politikë fiskale, rritje gjithëpërfshirëse, tatimet, shpenzimet publike, rritje, mirëqenie sociale.*